



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

Dokument konsultimi

Përmbledhje e shkurtër rreth draftit të Koncept dokument për Ligjin e Arsimit dhe Aftësisimit
Profesional në Republikën e Kosovës

Ky Koncept dokument është hartuar në zbatim të Vendimit të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 2-3316, dt. 01.11.2023, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 70/01 mars 2019), si dhe nenit 8, paragrafi 5 i Rregullores nr. 13/1013 për shërbimin ligjor qeveritar.

Qëllimi i Koncept dokumenti është harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës si dhe përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësisimit profesional dhe arsimit për të rritur, konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të IAAP-ve, harmonizimi i kualifikimeve në arsimin dhe aftësisimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe sigurimi i mundësive për realizimin e mësimin praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit dhe orientimit në karrierë.

Qëllimi i konsultimit

Gjatë hartimit të këtij Koncept dokumenti janë mbajtur një varg punëtorish me anëtarët e Grupit punues të emëruar me vendim të Sekretares së Përgjithshme.

Nga procesi i konsultimit presim të marrim propozime dhe opinionet nga të gjitha palët e interesit, në funksion të plotësimit dhe avancimit të mëtejshëm të draft-dokumentit, duke u siguruar që ky Koncept dokument ta arrijë qëllimin që ka.

Emri i personit/organizatës që jep komente: Bleta Kadriu

Fushat kryesore të veprimit të organizatës: Eksperte për verifikimin e standardeve të profesionit në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve;

Anëtare e Grupit Punes për rishikimin e Ligjit për Arsim dhe Aftësim Profesional;

Anëtare në Këshillin për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe të Rritur (tani dhe në të kaluarën);

Anëtare e Grupit punues për rishikimin e UA 35/2014;

Anëtare e Grupit punues për rishikimin e UA 28/2014

Anëtare e Grupit punues për zhvillimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe anëtare e rishikimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, si dhe anëtare në hartimin e udhëzimeve administrative të ndryshme, strategjive, udhëzuesev, etj.

Informatat e kontaktit të organizatës (adresa, e-mail, telefoni):
bleta.kadriu@rks-gov.net

Komentet: Këto janë komentet e mia profesionale në lidhje me këtë koncept dokument më qëllim të dhënies së kontributi profesional 15 vjeçar për sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional sepse kjo përvojë që ka filluar që nga themelimi i AKK si pjesë e stafit profesional me jep të drejtën të jap pikpamjet e mia përmes diskutimi publik si rrugë e reagimit lligjor. Më poshtë i gjeni të listuara të gjitha komentet e ndara në kapituj, paragrafe dhe faqet përkatëse në dokument.

Kapitulli 3: Opsionet

Faqe 23: Reforma në AAP në kontekst të thjeshtësimit, konsolidimit dhe rritjes së efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional duhet të ketë këto qëllime (të cilat janë të zberthyera në pjesën e mëposhtme në objektiva specifike):

- Njësimin e tërë strukturave të formës 'agjenci ekzekutive' apo trupa të ngjashme të themeluara me ligje apo akte nënligjore në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional, në një trupë të vetme, preferueshëm të formës agjenci e re ekzekutive pranë Ministrisë së Arsimit;
-

Komenti: Ky konstatim nuk është i faktuar dhe nuk është i qëndrueshëm sepse njësimi i të gjitha strukturave duke mos ju referuar qartë cilave agjenci, ekszekutive, cilave trupa të themeluara me ligje dhe aktet nënligjore vetëm sa konfuzionon sistemin duke mos paraparë rrezikun e cthurjes së sistemit kombëtar të kualifikimeve. Kjo nuk është matje dhe nuk është e gjetur sepse nuk është reformë progresive që në emër të thjeshtësisë të krijohet një agjenci e re dhe kjo do të ishte zgjedhja e problemit pa e pasur të njohur problemin apo ku është duke funksionuar keq sistemi. Shtrohet pyetja po mekanizmat dhe kriteret si do të organizohen si

do të menaxhohen sepse nuk është praktikë e zbatueshme që përmes një trupe të vetme të kryhen të gjitha funksionet e sigurimit të cilësisë së brendshme e të jashtme në sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional e aq me pak kur praktikatat evropiane të cilat kanë qenë pjesë e krijimit të këtij sistemi ekzistues dhe mbi të cilin sistemi evropian bazohet edhe sistemi i arsimit të Kosovës e deshmojnë të kundërtën. Mendoj se është dëshmuar mjaftueshëm se krijimi i një Agjencie të re pranë MASHT nuk mund të jetë e sukseshme dhe funksionale shembulli konkret është AAAPRr, agjenci që është në fazë të pilotitit afër 10 vite dhe me funksion të paqartë ligjore.

Duhet pasur kujdes çështjen e trupës dhe mekanizmit të ri që aludohet, sepse kjo nuk mund të shpërbejë sistemin e kualifikimeve kombëtare sepse Ligji për Kualifikime Kombëtare definon shumë qartë krijimin dhe menaxhimin e këtij sistemi. E aq me pak kur kjo është dëshmuar me punën e realizuar nga AKK, ku Korniza Kombëtare e Kualifikimeve e Kosovës është e harmonizuar përmes procesit të Referencimit me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve që nga viti 2016, kurse me këtë veprim me këtë koncept dokument ju rrezikoni që ta bëni edhe shkëputjen e kësaj lidhje.

Faqe 23 dhe 24: Reforma në AAP në kontekst të thjeshtësimit, konsolidimit dhe rritjes së efektivitetit të strukturës institucionale në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional duhet të ketë këto qëllime (të cilat janë të zbërthyera në pjesën e mëposhtme në objektiva specifike):

1. Harmonizimin e ligjeve të fushës së arsimit dhe aftësimin profesional në një akt të vetëm ligjor;
2. Njësimin e tërë strukturave të formës 'agjenci ekzekutive' apo trupa të ngjashme të themeluara me ligje apo akte nënligjore në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional, në një trupë të vetme, preferueshëm të formës agjenci e re ekzekutive pranë Ministrisë së Arsimit;
3. Fuqizimin e trupës së re me gamën e nevojshme të kompetencave në funksionet ekzekutive/administrative, mbështetëse, asistuese, financuese për IAAP-të dhe IAAPRr-të, dhe politikbërëse në të gjitha komponentët përveç politikave publike të formës ligj (të cilat mbesin përgjegjësi e DAAP-së);
4. Vendosjen e garancioneve të nevojshme të pavarësisë për komponentët vendimmarrës brenda trupës së re, të cilat janë përgjegjëse për akreditimin e IAAP-ve dhe IAAPRr-ve në kuptim të KKK-së;
5. Ndërlidhjen e vendimmarrjes së trupit të ri, në çështjet që janë kyçe për efektin përfundimtar të të diplomuarve në tregun e punës dhe sektorin e industrive të specializuara, në mënyrë të tillë që vendimmarrja e jetë e formatit korporativ (me industrinë apo koalicionet/grupet e tyre si akter qendror në vendimmarrje);
6. Krijimin e një linjë të qartë të llogaridhënies për trupën e re, dhe krijimin e një mekanizmi ligjor që parasheh transparencë dhe performancë të bazuar në rezultate përballë tri audiencave: a) Ministrisë së Arsimit, si institucioni ndaj së cilës trupa do ketë vartësi institucionale, b) IAAP-ve/IAAPRr-ve, të cilëve trupi i ri do i shërbej por edhe menaxhoj në kuptim të kompetencave të nivelit qendror, dhe, 3) akterëve në tregun e punës, ndaj të cilëve trupi i ri duhet tu dëshmojë dhënien e rezultateve në perspektivën e benefituesit përfundimtar.

Komenti: Këto kompetenca deri me tani kanë qenë të përcaktuara me ligjet në fuqi të MASHT. Tani me këto propozime ka ndërhyrje ndërhyrje edhe tek ligjet tjera përpos ligjit për AAP, pra merren kompetenca edhe nga Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsimin në Komuna, Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha këto ligje zbatohen dhe kanë gjetur zbatim nga organet përgjegjëse në Kosovë dhe të kërkohet që harmonizohen dhe të jetë një akt i vetëm ligjor, tani më nuk është thjeshtësimi të ciin po e kerkoni por kompleksitetin.

Tentimi që përmes këtij koncept dokumenti të zhvillohen elementet dhe mekanizmat të cilat janë ekszistues dhe aplikohen edhe sot është i gabuar dhe jo vizionar sepse rrezikohet që ky sistem të cthuret përmes veprimeve të tilla centralizuese të cilat në të gjitha rrethanat po dalin që MASHT dhe politika do të jetë pika vendimmarrëse duke rrezikuar parimet demokrtike dhe kushteuese të barazisë, transparencen dhe besueshmërinë e sistemit të kualifikimeve në Kosovë. Edhe ceshtja e llogaridhenies është shume e qartë, por mungesa e vullnetit për të fuqizuar dhe perkrahur AKK, arsyetohet në këtë koncept dokument si mungesë llogaridhënie që është i gabuar. Nese merren dhe analizohen detalisht ligji për arsim dhe aftësim profesional dhe ligji për kualifikime do të shihni se janë në përputhje njëra me tjetrën sepse ligji për kualifikime kombëtare është bazë që është përdorur për harmonizimin e ligjeve të tjera, ku kjo ka qenë kërkese e raporteve të progresit nga BE, për të dëshmuar këtë MASHT i ka kërkesat e zyrës së BE atherë kur janë bërë këto harmonizime.

Gjithashtu, në këtë koncept dokument nuk është paraparë aspask çështja e arsimit dhe aftësimin profesional, mësimi tërë jetesëorë, casja gjithëpërfshirëse sai takon edhe IAAP dhe sektorit privat. Në njërën anë në koncept dokument parashihet përfshirja e tregut të punës në sistemin e harmonizimit të kërkesavë me kualifikimet, kurse në anën tjetar nuk trajtohet fare çështje e ofrimit të kualifikimeve nga sektori privat, kjo dëshmohet edhe me draft ligjin që është draftuar duke u bazuar në këtë koncept dokument. Nuk respektohet praimi i barazisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, trajtim i barabartë në casje dhe trajtim duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit në arsimin dhe aftësimin profesional.

Kapitulli 3.3: Adresimi i reformës së strukturës institucionale të arsimit dhe aftësimin profesional dhe KKK-së në Republikën e Kosovës përmes plotësim-ndryshimeve të ligjeve individuale ((Opsioni i tretë))

Faqe26: Një fuzionim i tillë është në përputhje me pritjet e Bashkimit Evropian në kuptim të Reformës së Administratës Publike , në të cilën MASHTI ka detyrim që të zvogëlojë numrin e agjencive ekzekutive për së paku një.

Komenti: Ky vlerësim është i pa bazuar, pasi që kërkesat e BE në reformimin e Administratës Publike nuk nënkupton fuzionim e institucioneve funksionale të cilat përbëjnë rezultate prej vitesh. Logjika e fuzionimit të AKK në emër të Reformës Administrative sepse ka kërkuar BE është totalisht i gabuar. Këtu duhet përmendur faktin se AKK është rezultat i investimit të BE prej 2 milion euro përmes IPA, me saktësisht projektit KOSVET V, dhe është njëra ndër insitucionet që vazhdon të shenoj progres sa i takon vetezhvillimit të saj dhe rregullimit të sistemit të kualifikimeve në Kosovë. Kjo dëshmohet me së miri me numrin e madh të inistucioneve të akredituar deri më tani janë rreth 107, numrin e kualifikimeve të validuara rerth 140, numrin e standardeve te verifikuar deri ne 200 sosh dhe me zhvillimin e komponentes së Njohes së Mësimin Paraprak, që Kosova sot përfaqësohet edhe si lider e vendeve të Ballkanit e më gjerë, e kjo falë edhe përkrahjesë së vazhdueshme të

BE, ETF, EQAVET, etj, Të listohen të arriturat dhe themelimi nga BE, dhe cenimi i implementimit të KKK dhe procesit të referencimit.

Komenti 2: AKK nuk është një agjenci ekzekutive, sepse vepron në marrëdhënie me Zyrën e Kryeministrit sipas Ligjit për Kualifikime Kombëtarë, andaj, duhet pasur kujdes në rastin e AKK, të mos përzihet obligimi dhe lidhja e AKK me agjenci ekzekutive, për shkak se AKK, në kuptim të Ligjit të aplikueshëm është një agjenci rregullatore, e njëjtte sikurse Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Faqe 26: Themelimi i trupës së re duhet bërë në mënyrë të tillë që raporti i saj me MASHTI-n të jetë i qartë dhe të mos lejojë hapësirë për dykuptimësi në linjën e saj llogaridhëse.

Komenti: Nuk është e qartë konstatimi mbi dykuptimësinë, për shkak se nga perspektiva e AKK, institucion ky i themeluar me ligj si organ i pavarur ka kompetenca të caktuara për vlerësimin e jashtëm të programeve dhe institucioneve, politike kjo e cila përbën një shkelje e pavarësisë së përgjegjësive të AKK. Mbi të gjitha, roli i MASHTI është në të gjitha rastet i përcaktuar qartë dhe se nuk ka një dykuptimësi, këtë e dëshmojnë të gjitha ligjet, udhëzimet administrative dhe udhëzuesit e AKK.

Faqe 26: Agjencisë do t'i përcaktohen funksione, kompetenca dhe përgjegjësi për arsimin dhe aftësimin profesional, përfshirë: zbatimin e politikave të AAP-së, validim dhe akreditim të programeve dhe akreditimin e IAAP-ve të arsimit dhe aftësimin profesional në kuptim të AAPARr, rregullimin e kualifikimeve kombëtare përfshirë popullimin e KKK-së dhe zbatimin e strategjive në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional, avancimin e arsimit dhe aftësimin profesional dhe sigurimin e cilësisë. Po ashtu, agjencia merret me zhvillimin profesional të mësimeve, përkrahjen dhe fuqizimin e IAAP-ve (planifikim të programeve, financimit, resurseve njerëzore, projekte ndërkombëtare), zhvillimin e kurrikulave, fuqizimin dhe promovimin e modaliteteve të mësuarit dual, për mësimin në vendin e punës, praktikave në kompani, praktikave profesionale etj, zbatimin e vlerësimeve të IAAP-ve.

Komenti: Të gjitha këto janë duke u zbatuar nga AKK përve zhvillimin profesional të mësimeve sepse këtë kompetencë e ka zyra e trajnimeve në MASHT. Të gjitha këto elemente janë të bazuar në parime dhe kritere të mbi bazën e të cilave janë hartuar dhe mekanizmat për implementim janë testuar dhe janë funksional, por të cilat kërrojnë avancim progresiv. Dua të theksoj edhe një element të popullimit të KKK, është duke u bërë vazhdimisht nga AKK me procesin e rregullt të bazuar në kritere të qara. Për të avancuar më tej AKK, tani më është në përfundim e sipër edhe Regjistri Kombëtar i Kualifikimeve në Kosovë, ku jën të përfshirë edhe sistemi i arsimit të lartë. Ky është një avancim i lartë sepse do të kemi edhe digjitalizim edhe të shërbimeve të AKK. Kjo është kërkesë edhe e BE si dhe për këtë kanë ofruar përkrahje edhe përmes projekteve milionshe. Thelbi i mos përputhjes, zhvillimi dhe vlerësimi, centralizim në një organ të vetëm është e kundërt me të gjeturat në terren si dhe propozimit tuaj që shkollat kanë nevojë për pavarësi financiare dhe insitucionale. Kemi përvojë të centralizimit të shkollave të IAAP nën AAPr, ku si mos funksionim efikas ka rezultuar se centralizimi nuk funksionon.

Faqe 26: Përmes ligjit të ri do të parashihet themelimi i një trupe të pavarur, që reflekton përfaqësimin e tre palëve relevante për AAP-në, përkatësisht industrinë, nxënësit dhe

autoritetin publik, dhe e cila do të vishet me kompetencën për të akredituar institucionet arsimore të AAP-së,

Komenti: Kjo është qasje jo e qëndrueshme dhe nuk ka një praktikë të tillë në asnjë vend me traditë në sigurimin e cilësisë dhe njëkohësisht krijon një konflikt të pavarësisë si dhe mundësisë se daljes jashtë kontrollit.

Në një agjenci e cila zhvillon programet, menaxhon me cilësinë e AAP, të jetë njëkohësisht përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm, kjo totalisht është në konflikt të vazhdueshëm të kompetencave dhe interesit. Me këtë paragraf shkelet Kushtetuta sepse parimi i barazisë së institucioneve private nuk është trajtuar fare në këtë koncept dokument, e një njërën anë thuani të përfshini tregun e punës kurse që në fillim u mohoni të drejtën për tu trajtuar njëjtë në sistemin arsimor. Parimet dhe kriteret e sigurimit të cilësisë në sistemin arsimor janë të njëjta si në sektorin publik po ashtu edhe në sektorin privat. Tregu i lirë është parim kryesor i sistemit demokratik andaj edhe kjo me këtë koncept dokument mohohet.

Faqe 26: Vendimet e saj do jenë thellësisht të bazuara në përcaktimet strategjike të arsimit dhe aftësimin profesional

Komenti: Vendimet duhet të bazohen në kriteret transparente sepse në të kundërtën janë vendime subjektive dhe elemente për ballfaqim në gjykata. Nëse vendimet e një trupe rregullative duhet të bazohen në përcaktimet e politikave të MASHT brenda strategjive, kjo përbën shkelje të pavarësisë së vendimmarrjes. Kjo sidomos për natyrën e një agjencie të pavarur rregullatore siç është AKK.

Faqe 26 dhe 27: Pavarësia e trupës së tillë do të sigurohet edhe përmes pamundësisë së shkarkimit të anëtarëve të saj, pos për arsye që lidhen me shkelje serioze të ligjit.

Komenti: Kjo është jashtë parimeve demokratike, ky funksion bie ndesh me LIGJIN NR. 05/L-031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE, dhe është e rregulluar çështja e organeve kolegjiale dhe përfaqësimi i tyre.

Faqe 27: Plotësim-ndryshimi i të tre ligjeve do të rezultojnë në një parashikim të qartë të një mekanizmi që e ndërlidh më përmbajtësisht institucionin dhe programin e AAP-së me nevojat e tregut të punës, për t'i dhënë kështu një dimension funksional ndërlidhjes së tillë.

Komenti: kjo është paragjykes sepse nuk dihet saktësisht se çfarë duhet të ndryshohet pse duhet të ndryshohet cilat jnaë të gjeturat që dëshmojnë ndryshimin, sa janë të përfshirë institucionet që do të përfshihen apo preken me këto ndryshime cilat janë sfidat dhe benefitet nga ky ndryshim. Vete paragrafi përmban institucionin, programin dhe tregun e punës të cilat një tri aspekte të rëndësishme dhe të cilat duhet të trajtohen secila me mekanizma të vecant por që takohen në një pikë. Me këtë paragraf të tillë konkludohet mekanizmi po vetem mekanizmi nuk është i qartë, transparentë, gjithëpërfshirës dhe kredibil. Në këtë pjesë ku dokumenti flet për krijimin e një trupe të pavarur, askund nuk përmenden garancionet ligjore të personave që janë të angazhuar në institucionet përkatëse dhe agjencitë, siguria juridike, tranzicioni, etj.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Faqe 28: Opsioni nr. 3

Figure 8: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Ndikimet kryesore të pritshme

Ndikimet buxhetore	Zbatimi i konceptdokumentit sipas këtij opsioni pritet të ketë impakt pozitiv buxhetor; do të ulen shpenzimet fikse për mbajtjen e dy agjencive, në një të vetme. Gjithashtu, do të ulët barra administrative që ka një kosto fikse relativisht të lartë.
--------------------	---

Komenti 1: Nuk ka ulje të barrës administrative për shkak se të dy institucionet kanë mungesë të administratës andaj është shumë i nevojshëm i tërë stafi administrativ.

Komenti 2: Në disa raste është përmendur barra administrative. Kur flitet për këtë argument, duhet të paraqitet saktësisht se për çfarë barre administrative bëhet fjalë dhe se përse barra administrative është kaq e lartë siç përmendet disa herë. Përkundrazi AKK është institucion që krijon të hyra vetanke, pra nuk është barrë administrative këtë e dëshmojnë të hyrat vetanake të AKK që mbledhen përmes proceseve të validimit dhe akreditimit, ku të hyrat vjetore për një vit janë rreth 100 mijë euro, e të cilat janë në rritje të vazhdueshme sepse ka rritje të kërkesave për validim dhe akreditim. Andaj, ky konstatim është i gabuar dhe nuk mund të përdoret si element për fuzionim.

faqe 29: Opsioni nr. 3

Figure 8: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Ndikimet kryesore të pritshme

Ndikimet ekonomike	Zbatimi i konceptdokumentit sipas këtij opsioni do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit. Ai do të mundësojë një ndërlidhje më të mirë të arsimit dhe aftësisht profesional me nevojat e tregut të punës dhe industrive prodhuese e shërbyese në Kosovë. Një rritje e harmonizimit ndërmjet të dyjave do të rrisë eficiencën e parasë publike, të rrisë produktivitetin e ekonomisë vendore dhe të sistemit arsimor në përgjithësi. Gjithashtu, fuzionimi i agjencive do kontribuojë në komplementimin e shërbimeve të të dyja institucioneve paraprake në një të vetëm, faktor i cili do ndikojë në zhvillimin e fuqisë punëtore.
--------------------	---

Komenti: Nuk është përshkrim i qëndrueshëm, nuk është i mëtshëm dhe si i tillë nuk mund të përdoret si element për fuzionim. Kjo faktin që propozimi i fuzionimit do të krijojë në zhvillimin e fuqisë punëtore nuk qëndron, për shkak se me këtë propozim humbet komponenti i cilësisë së jashtme të produkteve dhe shërbimeve të IAAP, duke marrë parasysh faktin se opsioni i zhvillimit dhe vlerësimit duhet të ketë pavarësi institucionale dhe krijimi i një trupe në mes do të krijojë situatë jo stabile duke mos marrë parasysh përvojën e AKK në procesin e vlerësimit. Këtu do të paraqes një të dhënë që besoj se nuk e keni marrë parasysh kur keni kërkuar këtë fuzionim. Fakti është se kur kandidatët përfundojnë një kualifikim të validuar në institucionet e akredituara nga AKK ajo diplome apo edhe certifikatë i njohet edhe në BE, vula e AKK është garatuese se cilësia ekziston dhe është e mundur që edhe kompanit dhe bizneset të kuptojnë se çfarë është i aftë kandidati të kryej fale shtojcës së diplomës/certifikatës. Ky është njëri ndër mekanizmat që tregojnë se ka ndikim pozitiv në

vend. Po ashtu, vendosja e një trupe të tretë në këtë, është shume e pa qartë dhe krijon hapësirë të dyshimit të kontrollit, e cila nëse jep llogari agjencisë së përbashkët, atëherë si mund të jete organ i pavarur?

Duhet pasur parasysh edhe faktin se nuk mund të kërkohet një fuzionim i agjencive që kanë një fushëveprim të ndryshëm ligjor dhe se duhet pasur kujdes në rolin ligjor që e ka AKK, sidomos në raport me Ligjin për Kualifikime Kombëtare.

Data e dërgimit të komenteve:

15.05.2024